

**LIGJ**  
**Nr.10 137, datë 11.5.2009**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI PËR LICENCAT,  
AUTORIZIMET DHE LEJET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

**Përkufizim i termave**

1. Ligji nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, përmendet më tej në këtë ligj me shkurtimin “Ligji për licencat”.
2. Termat e përdorur në ligjin për licencat kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë ligj.

KREU II

NDRYSHIME NË LIGJET E NDRYSHME, SIPAS FUSHAVE TË VEPRIMTARIVE DHE/OSE  
PËRDORIMIT TË TË MIRAVE

SEKSIONI I PARË

FUSHA E SIGURISË KOMBËTARE, RENDIT PUBLIK DHE MBROJTJES CIVILE

Neni 2

**Ndryshime në ligjin nr.7566, datë 25.5.1992 “Për armët”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.7566, datë 25.5.1992 “Për armët”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Veprimtaritë e prodhimit dhe/ose ndreqjes së armëve të zjarrit, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë I.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen në përputhje me dispozitat vijuese të këtij ligji. Prodhimi kryhet vetëm nga subjekte ku shteti kontrollon të drejtat pronësore. Ndrejja e armëve mund të bëhet edhe nga subjekte private. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre licencimeve.”.

2. Në fund të nenit 9 shtohen fjalët: “njohin armën dhe përdorimin e saj dhe gëzojnë besueshmëri.”.

3. Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

- a) Në paragrafin e parë fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “autorizim”.

- b) Paragrafi i dytë shfuqizohet.

4. Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 11/1

Veprimtaritë e prodhimit dhe/ose të tregtimit të armëve të gjahut dhe/ose sportive, pjesëve të tyre dhe/ose i municioneve përkatëse, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë I.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen në përputhje me dispozitat vijuese të këtij ligji. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre licencimeve.”.

5. Në nenin 16, pas fjalës “juridike” shtohen fjalët “si dhe e licencimit të veprimtarive të përcaktuara më sipër në këtë ligj”.

#### Neni 3

### **Ndryshime në ligjin nr.9707, datë 5.4.2007 “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe të mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”**

Në ligjin nr.9707, datë 5.4.2007 “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, në nenin 3 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Të gjitha veprimtaritë, që i nënshtrohen licencimit, sipas këtij ligji, përfshihen në kategorinë I.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen në përputhje me dispozitat vijuese në këtë ligj. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre licencimeve.”.

#### Neni 4

### **Ndryshime në ligjin nr.9126, datë 29.7.2003 “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”**

Në ligjin nr.9126, datë 29.7.2003 “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 2, fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “licencë”. Ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit për të njëjtin përdorim të fjalës leje si në këtë nen.

2. Në nenin 6, fjala “autorizuar” zëvendësohet me fjalën “licencuar”. Ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit për të njëjtin përdorim të fjalës “autorizuar” si në këtë nen.

3. Në nenin 7:

a) Në fund të pikës 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Të gjitha veprimtaritë, që i nënshtrohen licencimit, sipas këtij ligji, përfshihen në kategorinë I.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen në përputhje me dispozitat vijuese të këtij ligji. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre licencimeve.”.

b) Në pikat 2 dhe 3, fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “autorizim” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit për të njëjtin përdorim të fjalës “leje” si në këtë pikë.

#### Neni 5

### **Ndryshime në ligjin nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”**

Në ligjin nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, pas nenit 29 shtohet neni 29/1 me këtë përmbajtje:

#### “Neni 29/1

“Veprimtaritë e ekspertizës dhe/ose profesionale, parandaluese a ndërhyrëse, në fushën e mbrojtjes civile, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë I.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit të licencave.”.

#### Neni 6

### **Ndryshime në ligjin nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar,

pika 3 e nenit 34 shfuqizohet.

#### Neni 7

### **Ndryshime në ligjin nr.8770, datë 19.4.2001 “Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.8770, datë 19.4.2001 ”Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Fjalja hyrëse e nenit 1 zëvendësohet me fjalinë “Shërbimi i ruajtjes dhe i sigurisë fizike ka për mision”.

2. Në nenin 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 e nenit 2 shfuqizohet;

b) Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Shërbimi i ruajtjes dhe i sigurisë fizike, përcaktuar në këtë ligj, përfshihet në kategorinë I.3 të shtojcës së ligjit për licencat. Kjo veprimtari licencohet sipas ligjit të licencave.”.

3. Nenet 3, 4, e 5 shfuqizohen.

4. Në nenin 7, fjala “licencë” zëvendësohet me fjalën “certifikatë” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “licencë” si në këto nene.

5. Në nenet 14 dhe 15, fjala “licencë” zëvendësohet me fjalën “certifikatë” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “licencë” si në këtë nen.

6. Në nenin 14, pas shkronjës “d” të pikës 1 shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) plotëson kushtet ligjore për mbajtjen dhe përdorimin e armëve;”.

7. Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 14/1

Titullari i subjektit që licencohet duhet të gëzojë të gjitha cilësitë e përcaktuara për drejtuesin teknik, përjashtuar kriterin e moshës dhe të arsimit policor ose ushtarak dhe pajisjet me certifikatë, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji.”.

#### SEKSIONI I DYTË FUSHA E USHQIMIT DHE SHËNDETIT

#### Neni 8

### **Ndryshime në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”**

Në ligjin nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i kreut V ndryshohet si më poshtë:

“LICENCIMI DHE REGJISTRIMI I STABILIMENTEVE”.

2. Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

### **Licencimi dhe regjistrimi i operatorëve, i stabilimenteve ushqimore**

1. Veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.

2. Çdo stabiliment, për të cilin është marrë licenca, identifikohet në bazë të numrit që ka në regjistrin e posaçëm, të krijuar për këtë qëllim në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Operatorët janë të detyruar, që për ushqimin apo ushqim për kafshë, që ata prodhojnë, të shënojnë në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqërues numrin e regjistrimit.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit pezullon dhe /apo revokon licencën, me kërkesë të operatorëve të biznesit ushqimor apo në rast se gjatë kontrollit rezulton se nuk plotësohen kërkesat

tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare, fitosanitare apo veterinare, sipas këtij ligji.”

3. Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

### **Ndalimi i veprimtarisë së operatorëve të biznesit ushqimor**

Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund të pezullojë dhe/apo revokojë licencën, në përputhje me nenin 19 të këtij ligji, në rastet kur ka një rrezik serioz për shëndetin publik dhe është e nevojshme e urgjente marrja e masave parandaluese.”

4. Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 21

### **Tarifat për procedurën e licencimit**

1. Tarifat e licencimit të stabilimenteve dhe mënyra e shpërndarjes së të ardhurave prej tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Tarifa përballohet nga aplikuesi.”

5. Në nenet 28, 29 dhe 54 fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “autorizim” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “leje” si në këto nene.

6. Neni 52 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 52

Për licencimin e operatorëve dhe të stabilimenteve të biznesit ushqimor për kafshë, që prodhojnë ushqim për njerëzit dhe, përkatësisht, regjistrimi i tyre zbatohet në dispozitat e nenit 19 të këtij ligji.”

7. Në nenin 68 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikat 2 e 3 fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “licencë” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “leje” si në këtë nen;

b) Në pikën 2, fjalët “të pikave 1, 2, 12 e 13 të nenit 19” zëvendësohen me fjalët “të pikave 1 e 3 të nenit 19”.

Neni 9

### **Ndryshime në ligjin nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi”, të ndryshuar**

Në ligjin nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në ligj, fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “licencë”.

2. Në nenin 4, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni përfshihen në kategorinë II.1 shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.”

Neni 10

### **Ndryshime në ligjin nr. 9308, datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.9308, datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 9, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Veprimtaritë e shërbimit veterinar në klinika apo spitale veterinare, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II. 2 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit të licencave.”

2. Në nenin 20, fjalët “licencim” dhe “licencë” zëvendësohen, përkatësisht, me fjalët

“certifikim” dhe “certifikatë” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit për të njëjtin përdorim të fjalëve “licencim/licencë” si në këtë nen.

3. Në nenin 32, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Veprimtaritë e tregtimit me shumicë të kafshëve të gjalla dhe ato të kultivimit të kafshëve në fermat e akuakulturës përfshihen në kategorinë II.3 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit të licencave.”.

4. Në nenin 48, pikat 2 e 3 shfuqizohen.

5. Në nenin 76 pika 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Fjala “të autorizuar” zëvendësohet me fjalën “ të licencuara”.

b) Fjalët “ nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit” shfuqizohen.

6. Në nenin 77, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Veprimtaritë e prodhimit dhe/ose tregtimit të biopreparateve, medikamenteve dhe produkteve të tjera të këtij lloji, për kafshë të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.7 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.”.

Neni 11

### **Ndryshime në ligjin nr.8411, datë 1.10.1998 “Për ushqimin e blegtorisë”**

Në ligjin nr. 8411, datë 1.10.1998 “Për ushqimin e blegtorisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nenin 3, pika 13 shfuqizohet.

2. Në nenin 6, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Prodhimi, përpunimi dhe tregtimi i ushqimeve për kafshë, që nuk prodhojnë ushqim për njerëzit, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.”.

Neni 12

### **Ndryshime në ligjin nr.9426, datë 6.10.2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.9426, datë 6.10.2005 “Për mbarështimin e blegtorisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nenin 3, pika 65 shfuqizohet.

2. Në nenin 16 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Veprimtaritë agrolektorale, në ferma, të mëdha e të mesme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.3 të ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.”.

b) Në pikën 3, fjala “kriteret” zëvendësohet me fjalët “kushtet teknike të hollësishme.”.

3. Në nenin 43 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 4 shfuqizohet.

b) Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Kushtet teknike të hollësishme për veprimtarinë e stacioneve të provës, procedurat dhe metodat e provës miratohen nga ministri që mbulon çështjet e bujqësisë dhe të blegtorisë.”.

4. Në nenin 49, fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “autorizim” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “leje” si në këtë nen.

5. Në nenin 53, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Stacioni i ndërzimit natyror e ushtron veprimtarinë, nëse plotëson kriteret për personelin teknik, pajisjet, mjetet dhe riprodhuesit meshkuj.”.

2. Kushtet e hollësishme teknike për ushtrimin e veprimtarisë në stacionet e ndërzimit natyror miratohen nga ministri që mbulon çështjet e bujqësisë dhe të blegtorisë.”.

6. Në nenin 55, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kushtet e hollësishme teknike për mbledhjen, ruajtjen, transferimin dhe tregtimin e embrioneve miratohen nga ministri që mbulon çështjet e bujqësisë dhe blegtorisë.”.

7. Në nenin 57, pika 1 shfuqizohet.

8. Në nenin 63, pika 2 shfuqizohet.

9. Në nenin 64, pika 6 ndryshohet si më poshtë:  
“6. Veprimtaritë e importit e të eksportit, të përcaktuara në këtë nen, përfshihen në kategorinë II.2 të ligjit për licencat. Licencimi i tyre bëhet sipas ligjit për licencat.”.

10. Në nenin 77:

a) Fjalja hyrëse e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Organizata e mbarështuesve të kafshëve të racës miratohet kur:”;

b) Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Miratimi apo njohja sipas këtij neni bëhet nëpërmjet dhënies së licencës, që përfshihet në kategorinë II.2 të ligjit për licencat. Licencimi kryhet sipas ligjit për licencat.”.

11. Në nenin 80, fjalja hyrëse e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“Aplikimi për njohjen e një organizate mbarështuesish refuzohet kur:”.

12. Në nenin 81, pika 1 shfuqizohet.

13. Në nenin 82 bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, fjalët “ministrinë përkatëse” zëvendësohen me fjalët “organin kompetent”.

b) Pika 3 shfuqizohet.

14. Në nenin 85 bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 2, pas fjalëve “qendrat e prodhimit të kafshëve të racës” shtohen fjalët “dhe qendrat e prodhimit të materialit racor, inseminatorët e organizuar”.

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Miratimi sipas këtij neni bëhet nëpërmjet dhënies së licencës së kategorisë II.2 të ligjit për licencat. Licencimi kryhet sipas ligjit për licencat.”.

15. Në nenin 86, fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “licencë” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “leje” si në këtë nen.

Neni 13

#### **Ndryshime në ligjin nr. 8944, datë 19.9.2002**

#### **“Për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit”**

Në ligjin nr. 8944, datë 19.9.2002 “Për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit”, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 3 pika 2, fjalët “lejet tekniko-teknologjike dhe profesionale të” zëvendësohet me fjalët “licencën e”.

2. Në nenin 8, fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “licencë” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “leje” si në këtë nen.

Neni 14

#### **Ndryshime në ligjin nr. 9199, datë 26.2.2004 “Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve “bio”**

Kudo në ligjin nr.9199, datë 26.2.2004 “Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve bio, shprehja “leje e përkohshme” zëvendësohen me “autorizim i përkohshëm”.

Neni 15

#### **Ndryshime në ligjin nr.8732, datë 24.1.2001 “Për materialin mbjellës bimor”**

Në ligjin nr.8732, datë 24.1.2001 “Për materialin mbjellës bimor”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “a”, fjalët “leje ose autorizim” zëvendësohen me “pëlqimi”.

b) Shkronja “d” shfuqizohet.

c) Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Kushtet e hollësishme teknike për riprodhimin dhe shumëzimin miratohen nga ministri që mbulon çështjet e bujqësisë dhe të blegtorisë.”.

ç) Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) veprimtaritë e krijimit, të shumimit dhe riprodhimit të materialit mbjellës bimor

përfshihen në kategorinë II.4, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.”.

2. Neni 7 shfuqizohet.

3. Në nenin 8 paragrafi i fundit, fjala “lejohe” zëvendësohet me fjalën “autorizohet”.

#### Neni 16

### **Ndryshime në ligjin nr. 9362, datë 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, të ndryshuar**

Në ligjin nr. 9362, datë 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 23 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Veprimtaritë e prodhimit, të tregtimit dhe importi i PMB-ve të rrezikshme dhe me rrezikshmëri të lartë, sipas këtij ligji, përfshihen në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat”.

b) Pikat 3 e 4 shfuqizohen.

2. Në nenin 25, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. PMB-të e klasifikuara “PMB me rrezikshmëri dhe rrezik të lartë” përdoren vetëm nga personat e diplomuar në fushën e agronomisë ose që kanë të punësuar persona të diplomuar në fushën e agronomisë dhe nga ata, që janë të pajisur me dëshmi aftësie të veçantë. PMB-të e klasifikuara “PMB të rrezikshme” përdoren nga persona të pajisur me dëshmi aftësie, ndërsa ato të klasifikuara “PMB-të e tjera” përdoren pa dëshmi.”.

#### Neni 17

### **Ndryshime në ligjin nr. 8531, datë 23.9.1999 “Për shërbimin e kontrollit të plehrave kimike”**

Në ligjin nr.8531, datë 23.9.1999 “Për shërbimin e kontrollit të plehrave kimike”, kreu II ndryshohet si më poshtë:

#### “KREU II

#### IMPORTI, TREGTIMI DHE PRODHIMI I PLEHËRAVE KIMIKE

#### Neni 4

1. Veprimtaritë e prodhimit, tregtimit, importit të plehrave kimike me rrezikshmëri, të lejuara sipas këtij ligji, përfshihen në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.”.

2. Çdo subjekt, që tregon, importon apo prodhon plehra kimike duhet të veprojë në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.”.

#### Neni 18

### **Ndryshime në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar**

Në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve” të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 4 fjalia e fundit, fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “autorizim” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “leje” si në këtë nen.

2. Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

1. Veprimtaritë e përpunimit industrial dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.

2. Licenca, sipas pikës 1 të këtij neni, u jepet subjekteve, që plotësojnë kushtet teknike dhe teknologjike për përpunimin industrial dhe/ose prodhimin e produkteve të duhanit ose që kanë kontratë për përpunim industrial dhe/ose prodhim të produkteve të duhanit, me subjekte, që plotësojnë kushtet e mësipërme, me të drejtë ripërsëritjeje.”

3. Kudo në nenin 22, fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “licencë” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “leje si në këtë nen.”.

Neni 19

**Ndryshime në ligjin nr. 8880, datë 15.4.2002  
“Për të drejtat e seleksionerit të bimëve”**

Në ligjin nr. 8880, datë 15.4.2002 “Për të drejtat e seleksionerit të bimëve”, në nenet 3 pika 12 dhe 24 fjala “licencë” zëvendësohet me fjalën “njohje”.

Neni 20

**Ndryshime në ligjin nr.9106, datë 17.7.2003  
“Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 3, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Veprimtaritë e shërbimit spitalor, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.6, të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit të licencave.”.

2. Neni 25 shfuqizohet.

3. Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31

Hapja, klasifikimi dhe licencimi i spitaleve bëhen pas plotësimit të kriterëve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.”.

4. Nenet, 43, 44, 45 e 46 shfuqizohen.

5. Neni 47 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 47

1. Ministria e Shëndetësisë kryen inspektimin e vazhdueshëm të spitaleve, për zbatimin e kriterëve dhe të standardeve të miratuara.

2. Në rastin e mosplotësimit të kriterëve dhe standardeve të miratuara, spitali paralajmërohet për të shmangur shkeljet brenda një afati të përshtatshëm, që përcaktohet në aktin e paralajmërimit.

3. Kur spitali nuk i përmirëson shkeljet e konstatuara brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 2 të këtij neni, Ministri i Shëndetësisë vendos heqjen e licencës. Ministri i Shëndetësisë nuk mund ta heqë licencën pa shqyrtuar argumentet e subjektit të licencuar.”.

6. Neni 49 shfuqizohet.

Neni 21

**Ndryshime në ligjin nr. 9928, datë 9.6.2008  
“Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë”**

Në ligjin nr. 9928, 9.6.2008 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

1. Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

Veprimtaritë e institucioneve të shërbimit shëndetësor stomatologjik privat, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.6 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit të licencave.”.

2. Në nenin 11 pika 1, fjalët “dhe neni 6 pika 2” shfuqizohen.

Neni 22

**Ndryshime në ligjin nr. 8876, datë 4.4.2002  
“Për shëndetin riprodhues”**

Në ligjin nr. 8876, datë 4.4.2002 “Për shëndetin riprodhues”, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 14, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Veprimtaritë e përcaktuara në këtë ligj përfshihen në kategorinë II.6, të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit për licencat.”.

2. Në nenin 23, në fund të pikës 1 fjalët “mbi bazën e udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë” shfuqizohen.

Neni 23

**Ndryshime në ligjin nr. 9739, datë 21.5.2007  
“Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”**

Në ligjin nr. 9739, datë 21.5.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Veprimtaritë e qendrave të fraksionizimit të plazmës, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.6, të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit për licencat.”.

Neni 24

**Ndryshime në ligjin nr. 8193, datë 6.2.1997  
“Për transplantimin e organeve”**

Në ligjin nr. 8193, datë 6.2.1997 “Për transplantimin e organeve”, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 23, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Transplanti i organeve, i përcaktuar në këtë ligj, përfshihet në kategorinë II.6 të ligjit për licencat. Kjo veprimtari licencohet sipas ligjit për licencat.”.

2. Në nenin 25 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Fjalët “Ministria e Shëndetësisë dhe Ambientit” zëvendësohet me fjalët “Ministri që mbulon fushën e shëndetësisë.”

b) Pas fjalës “rregulloret” shtohet fjala “e tjera”.

Neni 25

**Ndryshime në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004  
“Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar**

Në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pas nenit 3 shtohet neni 3/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 3/1

Veprimtaritë e përcaktuara në këtë ligj përfshihen në kategorinë II.7 të ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit për licencat.”.

2. Neni 7 shfuqizohet.
3. Në nenin 19 fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “autorizim”.
4. Në nenin 22 pika 2, fjalët “të miratuara zyrtarisht” zëvendësohen me fjalën “të certifikuara” dhe fjalët “të miratuara edhe nga Ministri i Shëndetësisë” shfuqizohen.
5. Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

**Tregtimi me shumicë i barnave**

1. Tregtimi me shumicë i barnave kryhet nga shpërndarësi farmaceutik, që është person juridik ose fizik, tregtar, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë për këtë veprimtari.

2. Shpërndarësi farmaceutik mund të tregtojë me shumicë edhe materiale mjekimi, aksesorë, si dhe artikuj higjieno-kozmetikë dhe dietetikë.”.

6. Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31

**Drejtuesi teknik i farmacisë**

1. Funkcionin e drejtuesit teknik të farmacisë e ushtron çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe çdo shtetas i huaj, që plotëson këto kushte:

- a) ka arsimin e lartë për farmaci;
- b) ka një përvojë pune prej dy vjetësh në farmaci;
- c) është anëtar i Urdhrit të Farmacistëve.

2. Drejtuesi teknik i farmacisë e ushtron këtë rol vetëm për një farmaci dhe me kohë të plotë.

3. Farmacia lejohet ta ushtrojë veprimtarinë vetëm në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar.

4. Drejtuesi teknik dhe farmacistët e punësuar në farmaci regjistrohen pranë DSHP-së rajonale.”.

7. Neni 32 shfuqizohet.

8. Në nenin 35 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Në pikën 1 fjalët “mbi bazën e vetëdeklarimit të tij për plotësimin e kriterëve të kërkuara” shfuqizohen.

- b) Pikat 2 shfuqizohet.

9. Në nenin 46 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Importuesi dhe/ose eksportuesi farmaceutik duhet të ketë një drejtues teknik, me cilësitë e përcaktuara në nenin 25, të këtij ligji.”.

- b) Pika 2 shfuqizohet.

10. Në nenin 57, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kryerja e veprimtarive pa licencën përkatëse, sipas nenit 3/1, të këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me sekuestrim të barnave dhe heqje të licencës.”.

Neni 26

**Ndryshime në ligjin nr.7975, datë 26.7.1995**

**“Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, të ndryshuar**

Në ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 13 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Fjala “licencë” zëvendësohet me fjalën “autorizim” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha

nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “licencë” si në këtë nen.

b) Në paragrafin e parë fjala “e posaçme” shfuqizohet;

c) Në fjalinë e fundit fjala “leje” zëvendësohet me fjalët “autorizim i posaçëm” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “leje” si në këtë nen.

2. Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

Çdo ndryshim i objektit, i emrit të personit juridik, i natyrës së veprimtarisë të tij, çdo ndryshim i bimëve, lëndëve dhe përgatitësve të tabelave II e III, që përfshihen në veprimtarinë, për të cilën subjekti është pajisur me autorizim, njoftohet pranë Ministrisë së Shëndetësisë, për të reflektuar ndryshimet në autorizimin përkatës.”

3. Në shkronjën “B” përpara neni 31 dhe në vijim fjala “leja/e” zëvendësohet me fjalët “autorizim i posaçëm”.

4. Në nenin 44, fjala “autorizim” zëvendësohet me fjalët “autorizim import-eksporti” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “autorizim” si në këtë nen.

### SEKSIONI I TRETË

### FUSHA E MJEDISIT DHE BURIMEVE MJEDISORE BAZË

Neni 27

#### **Ndryshime në ligjin nr. 8093, datë 16.11.2000 “Për rezervat ujore”, të ndryshuar**

Në ligjin nr. 8093, datë 16.11.2000 “Për rezervat ujore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas neni 25 shtohet neni 25/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/1

Lejet dhe kontratat koncensionare, që jepen sipas procedurave të këtij kreu, përfshihen në kategorinë III.6 të shtojcës së ligjit për licencat. Miratimi i tyre bëhet sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji.”

2. Pas neni 36 shtohet neni 36/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 36/1

Lejet dhe kontratat koncensionare, që jepen sipas procedurave të këtij kreu, përfshihen në kategorinë III.6 të shtojcës së ligjit për licencat. Miratimi i tyre bëhet sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji.”

3. Në nenin 24, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shpuesi profesionist për ujë, që e ushtron veprimtarinë mbi bazë tregtare, duhet të jetë i pajisur me licencën e parashikuar në kategorinë III.7, të shtojcës së ligjit për licencat. Kjo veprimtari licencohet sipas ligjit për licencat.”

4. Në nenet 46 e 48, fjala “leje” zëvendësohet me fjalët “autorizim të posaçëm” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “leje” si në këtë nen.

5. Në nenin 40 pika 2, në fund të shkronjës “c” shtohen fjalët “sipas këtij ligji”.

Neni 28

#### **Ndryshime në ligjin nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa

dhe ndryshime:

1. Në nenin 17, pas pikës 2 shtohen pikat 3 e 4 me këtë përmbajtje:

“3. Veprimtaritë e lidhura me zëvendësimin e lëndëve ozonholluese përfshihen në kategorinë III.3 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit për licencat.

4. Çdo import i veçantë i lëndëve ozonholluese, për qëllime zëvendësimi, mund të kryhet në bazë të një autorizimi të posaçëm, lëshuar nga ministri dhe brenda kuotave të përcaktuara për Shqipërinë.”.

2. Në nenin 23, fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “autorizim” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “leje” si në këtë nen.

3. Në nenin 31 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ministri miraton certifikimin e individëve si specialistë për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor, sipas rregullave, procedurave e kritereve, që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

b) Në nenin 31, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Veprimtaritë e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, kur kryhen nga subjekte juridike ose fizike, tregtare i nënshtrohen licencimit dhe përfshihen në kategorinë III.2, të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen, sipas ligjit për licencat.”.

4. Në nenin 34, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Deklarata mjedisore, leja mjedisore, leja e integruar mjedisore, autorizimi mjedisor dhe pëlqimi mjedisor, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë III.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Miratimi i tyre bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos përdorimin e njëres nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori.”.

5. Në nenin 36 pika 3, fjalët “nga ministri, vetëm në kushtet e parashikuara në këtë ligj” zëvendësohen me fjalët “vetëm sipas dispozitave të këtij ligji”.

6. Në nenin 39, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Personat fizikë dhe juridikë, publiku dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore mund të ankohen në gjykatën kompetente, sipas legjislationit në fuqi.”.

Neni 29

#### **Ndryshime në ligjin nr.9537, datë 18.5.2006**

#### **“Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar**

Në ligjin nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar, neni 11 shfuqizohet.

Neni 30

#### **Ndryshime në ligjin nr. 9010, datë 13.2.2003**

#### **“Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa :

1. Në nenin 17, fjalia e dytë e pikës 1 shfuqizohet.

2. Pas nenit 24 shtohet nenin 24/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 24/1

Licencat e parashikuara në krerët II e III, të këtij ligji, përfshihen në kategorinë III.2, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.”.

3. Në fund të nenit 26 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Çdo import i veçantë mund të kryhet në bazë të një autorizimi të posaçëm të Këshillit të Ministrave.”.

4. Në nenet 27 e 28, fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “autorizim” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “leje” si në këtë nen.

Neni 31  
**Ndryshime në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995**  
**“Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nenet 14 -21 dhe kudo në dispozitat e këtij ligji fjalët “licencë profesionale peshkimi” zëvendësohen me fjalët “leje profesionale peshkimi”.

2. Në nenin 15 pika 1, fjalia “e cila lëshohet nga ministri, pas miratimit nga bordi i peshkimit, në bazë të kërkesës për ushtrim veprimtarie” shfuqizohet.

3. Në nenin 15, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Leja e peshkimit profesional, sipas këtij neni, përfshihet në kategorinë III.5, të shtojcës së ligjit për licencat dhe jepet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave të këtij neni dhe atyre në vijim të këtij ligji: Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori dhe miraton procedurat e lejimit.”.

4. Në nenin 27, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Veprimtaria e akuakulturës zhvillohet nga subjektet fizike ose juridike, tregtare, të cilat kanë objekt të veprimtarisë akuakulturën. Dhënia në përdorim e pronave publike për zhvillimin e akuakulturës, tokësore dhe ujore, bëhet në bazë të lejes së përfshirë në kategorinë III.6, të shtojcës së ligjit për licencat dhe leja jepet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave të këtij neni dhe të neneve në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori dhe miraton procedurat përkatëse.”.

5. Në nenin 27, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Personat fizikë ose juridikë, tregtarë, të interesuar për zhvillimin e akuakulturës, tokësore dhe ujore, në pronat publike, u nënshtrohen procedurave të konkurrimit publik. Ministria ose përfaqësuesi i pronës shtetërore lidh me fituesin kontratën e qirasë. Procedurat për lidhjen e kontratës dhe ato të konkurrimit publik nuk zbatohen në rastet kur toka është në pronësi private.”.

6. Në nenin 31, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1 Administrimi i lagunave dhe i zonave të tjera, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshihet në kategorinë III.5, të shtojcës së ligjit për licencat dhe trajtohet sipas dispozitave më poshtë këtij neni dhe të neneve në vijim, të këtij ligji.”.

7. Në nenin 31, pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6/1. Dhënia e së drejtës së peshkimit, sipas pikës 6 të këtij neni, përfshihet në kategorinë III.5, të shtojcës së ligjit për licencat dhe trajtohet sipas dispozitave të këtij neni dhe të neneve në vijim, të këtij ligji.”.

8. Në nenin 28, fjala “ministra” zëvendësohet me fjalët “organi kompetent”.

Neni 32  
**Ndryshime në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005**  
**“Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nenin 5, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Për të siguruar asistencë të kualifikuar për hartimin e planeve të mbarështimit, të ekspertizave, të projekteve operacionale dhe zbatimin e tyre në fondin pyjor, ministri certifikon ekspertë, të certifikuar në këtë fushë. Kur këto veprimtari kryhen nga subjekte, juridike ose fizike, tregtare, ato i nënshtrohen licencimit dhe përfshihen në kategorinë III.7, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat. Këshilli i Ministrave miraton kriteret, rregullat dhe procedurat për certifikimin e ekspertëve dhe licencimin në fushën e fondit pyjor.”.

2. Në nenin 19, pas pikës 1 shtohet pika 1/1/ me këtë përmbajtje:

“1/1. Dhënia në përdorim, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshihet në kategorinë III.4, të shtojcës së ligjit për licencat dhe bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji.

Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra sipas ndarjes në nënkategori.”.

3. Në nenin 26, pas pikës 16 shtohet pika 17 me këtë përmbajtje:

“17. Dhënia në përdorim e të mirave publike, sipas këtij neni, nëse është kompetencë e institucioneve qendrore, përfshihet në kategorinë III.4 të shtojcës së ligjit për licencat dhe bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave të parashikuara në këtë nen dhe në nenet në vijim të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori.”.

4. Pas nenit 26 shtohet neni 26/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 26/1

Veprimtaritë e shfrytëzimit në fondin pyjor, përveçse kur kryhen nga banorët dhe për nevojat e tyre, sipas këtij ligji, mund të realizohen vetëm nga individë të certifikuar, në përputhje me procedurat e miratuara nga Këshilli i Ministrave. Kur këto veprimtari kryhen nga subjekte, juridike ose fizike, tregtare, u nënshtrohen licencimit dhe përfshihen në kategorinë III.7, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.”.

Neni 33

### **Ndryshime në ligjin nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”**

Në ligjin nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 15 bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

a) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Dhënia në përdorim për kullotje, nëse është kompetencë e institucioneve qendrore, përfshihet në kategorinë III.4, të shtojcës së ligjit për licencat dhe miratohet sipas dispozitave të parashikuara në këtë nen dhe në nenet në vijim të këtij ligji.”.

b) Në pikën 6, fjala “ministri” zëvendësohet me fjalët “Këshilli i Ministrave”.

2. Në nenin 17 bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

a) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Dhënia në përdorim sipas pikës 1 të këtij neni, nëse është kompetencë e institucioneve qendrore, përfshihet në kategorinë III.4, të shtojcës së ligjit për licencat dhe bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave të parashikuara në këtë nen dhe në nenet në vijim të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori.”.

b) Në pikën 4, fjala “ ministri” zëvendësohet me fjalët “Këshilli i Ministrave”.

3. Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

### **Certifikimi i ekspertëve dhe licencimi i tyre**

1. Për të siguruar asistencë të kualifikuar për hartimin e planeve të mbarështimit, të ekspertizave, të projekteve operationale dhe zbatimin e tyre në kullotat shtetërore dhe private, ministri, që mbulon fondin kullosor, certifikon ekspertë në fushën e kullotave dhe të livadheve.

2. Kur këto veprimtari kryhen nga subjekte juridike ose fizike, tregtare, i nënshtrohen licencimit dhe përfshihen në kategorinë III.7, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat”.

3. Këshilli i Ministrave miraton kriteret, rregullat dhe procedurat për certifikimin e ekspertëve dhe licencimin në fushën e kullotave dhe të livadheve.”.

Neni 34

### **Ndryshime në ligjin nr.10120, datë 23.4.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”**

Në ligjin nr.10120, datë 23.4.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”, pas pikës 2 të nenit 24 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Dhënia e lejes, nëse është kompetencë e institucioneve qendrore, përfshihet në kategorinë

III.4 të shtojcës së ligjit për licencat dhe bëhet sipas procedurave të parashikuara në këtë nen dhe në nenet në vijim të këtij ligji.”.

Neni 35

**Ndryshime në ligjin nr. 10 006, datë 23.10.2008  
“Për mbrojtjen e faunës së egër”**

Në ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, pika 5 e nenit 21 ndryshohet si më poshtë:

“5. Përdorimi i llojeve të faunës së egër apo i individëve të tyre përfshihet në kategorinë III.5, të shtojcës së ligjit për licencat dhe bëhet sipas procedurave të ligjit për licencat apo sipas dispozitave të parashikuara në këtë nen dhe në nenet në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njëres nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori.”.

Neni 36

**Ndryshime në ligjin nr.7875, datë 23.11.1994  
“Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.7875, datë 23.11.1994 “Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa :

1. Në nenin 13, fjala “miratimin” zëvendësohet me fjalën “autorizimin” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “miratim” si në këtë nen.

2. Në nenin 14, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Dhënia në përdorim e pjesëve të fondit publik të gjuetisë, për qëllimet e caktuara në paragrafin e parë të këtij neni, bëhet në bazë të lejes, që përfshihet në kategorinë III.5, të shtojcës së ligjit për licencat dhe bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave të parashikuara në këtë nen dhe në nenet në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njëres nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori.”.

3. Në fund të nenit 18 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Leja, sipas paragrafit të dytë të këtij neni, përfshihet në kategorinë III.5, të shtojcës së ligjit për licencat dhe bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave të parashikuara në këtë nen dhe në nenet në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njëres nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori.”.

4. Në nenin 23, pikat 1 e 2 numërohen, përkatësisht, 2 e 3, si dhe shtohet pika 1 me këtë përmbajtje:

“1. Leja e mbarështimit të faunës së egër dhe leja e gjuetisë sportive e turistike, të organizuar, përfshihen në kategorinë III.5 të shtojcës së ligjit për licencat dhe bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave të parashikuara në këtë nen dhe në nenet në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njëres nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori.”.

**SEKSIONI I KATËRT**

**FUSHA E BURIMEVE MINERARE, HIDROKARBURE DHE ENERGJETIKE**

Neni 37

**Ndryshime në ligjin nr.7796, datë 17.2.1994  
“Ligji mineral i Shqipërisë”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.7796, datë 17.2.1994 “Ligji mineral i Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 9/1

Të drejtat minerare, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë IV.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Të drejtat minerare jepen sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njëres nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në

nënkategori. Në rastin e dytë nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.”.

2. Në nenin 20 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “certifikatë”.

2. Në fund shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Veprimtaritë e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni kur kryhen nga subjekte, juridike ose fizike, tregtare, përfshihen në kategorinë IV.4 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit të licencave.”.

Neni 38

**Ndryshime në ligjin nr.7746, datë 28.7.1993**

**“Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në fund të nenit 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kërkimi, zbulimi, shfrytëzimi i hidrokarbureve dhe operacione të tjera, të përcaktuara në këtë ligj, bëhen vetëm nga subjektet, me të cilat lidhen marrëveshje hidrokarbure, që përfshihen në kategorinë IV.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Këto marrëveshje lidhen, në përputhje me dispozitat në vijim, të këtij ligji. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre marrëveshjeve.”.

2. Në nenit 12, në shkronjën “a” të pikës 2 fjala “licencë” zëvendësohet me fjalën “leje” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “licencë” si në këtë nen.

Neni 39

**Ndryshime në ligjin nr.9663, datë 18.12.2006**

**“Për koncesionet”, të ndryshuar**

Në ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, në fund të nenit 3 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Kur kontrata koncesionare lidhet me përdorimin e një të mire publike, sipas këtij ligji ajo përfshihet në kategorinë IV.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Kontratat koncesionare lidhen në përputhje me dispozitat në vijim, të këtij ligji. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre kontratave.”.

Neni 40

**Ndryshime në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003**

**“Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pas pikës 1 të nenin 34/1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Ndërtimi i burimeve të reja gjeneruese, sipas pikës 1 të nenit 34/1, të këtij ligji, përfshihet në kategorinë IV.3, të shtojcës së ligjit për licencat. Këto leje miratohen në përputhje me dispozitat në vijim, të këtij ligji. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre lejeve.”.

SEKSIONI I PESTË

FUSHA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE NDËRTIMIT

Neni 41

**Ndryshime në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin**

**dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1

Veprimtaritë e projektimit, zbatimit të punimeve në ndërtim, mbikëqyrja e kolaudimit, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë V.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit për licencat.”.

Neni 42

**Ndryshime në ligjin nr.8405, datë 17.5.1998  
“Për urbanistikën”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.8405, datë 17.05.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, pas nenit 6 shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1

Të gjitha llojet e lejeve, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë V.2, të shtojcës së ligjit për licencat. Këto leje jepen sipas dispozitave në vijim të këtij ligji.”.

SEKSIONI I GJASHTË  
FUSHA E TRASHËGIMISË KULTURORE

Neni 43

**Ndryshime në ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003  
“Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenet 16, 19 e 40 fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “autorizim”.

2. Në nenin 17 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Veprimtaria restauruese e këtyre subjekteve private, e përcaktuar në këtë ligj, përfshihet në kategorinë VI.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Kjo veprimtari licencohet sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji.”.

3. Në nenin 39, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Rrjetëzimi ose shfrytëzimi i Monumenteve të Kulturës, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë VI.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto leje jepen sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.”.

4. Në fund të nenit 43 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Veprimtaria kërkimore arkeologjike e këtyre subjekteve private përfshihet në kategorinë VI.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Kjo veprimtari licencohet sipas dispozitave në vijim të këtij ligji.”.

Neni 44

**Ndryshime në ligjin nr.9380, datë 28.4.2005  
“Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera, të lidhura me të”**

Në ligjin nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera, të lidhura me të”, fjalia e parë e pikës 1 të nenit 108 ndryshohet si më poshtë:

“Agjencitë e administrimit kolektiv janë organizata jofitimprurëse. Veprimtaria e tyre përputhet me kategorinë VI.3 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto agjenci licencohen nga ministri, që mbulon këtë fushë, me propozimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, sipas dispozitave në vijim të këtij ligji.”.

SEKSIONI I SHTATË  
FUSHA E TRANSPORTIT

Neni 45  
**Ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998**  
**“Për transportet rrugore”, të ndryshuar**

Në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pas nenit 3 shtohet neni 3/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 3/1

Veprimtaritë e transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, për të tretë a me qira, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen, respektivisht, në kategoritë VII.1 e VII.2, të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njëres nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje. Veprimtaritë e tjera të transportit, të përcaktuara në këtë ligj, licencohen ose autorizohen sipas dispozitave vijuese në të.”.

2. Në nenin 30 bëhen këto ndryshime e shtesa:

- a) Fjalët “në linja të rregullta” shfuqizohen;
- b) Pas fjalëve “nga persona juridikë” shtohen fjalët “ose persona fizikë tregtarë”.

3. Neni 32 shfuqizohet.

4. Neni 40 shfuqizohet.

Neni 46  
**Ndryshime në ligjin nr. 9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e**  
**mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të**  
**braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”**

Në ligjin nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë, që lidhen me to”, bëhen këto ndryshime e shtesa :

1. Kudo në këtë ligj fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “autorizim”.

2. Pas nenit 2 të kreut I shtohet neni 2/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 2/1

Veprimtaritë e përcaktuara në nenet 3, 12, 14, 16, 18, 20 e 26, të këtij ligji, përfshihen në kategorinë VII.3 të ligjit për licencat. Termi “regjistrim” i përdorur në këto nene, zëvendësohet me fjalën “licencim”. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njëres nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori.”.

Neni 47  
**Ndryshime në ligjin nr.8905, datë 6.6.2002**  
**“Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”**

Në ligjin nr.8905, datë 6.6.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, pas pikës 3 të nenit 11 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Veprimtaria e largimit të mbeturinave dhe hidrokarbureve të përdorura, e përcaktuar në këtë nen, përfshihet në kategorinë VII.5, të ligjit për licencat. Kjo veprimtari licencohet sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji.”.

SEKSIONI I TETË  
FUSHA E INDUSTRIVE DHE SHËRBIMEVE TË TJERA

Neni 48

**Ndryshime në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Veprimtaritë e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë VIII.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë, nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.”

2. Në nenet 12, 17, 19, 21, e 25 fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “licencë”.

3. Në nenet 15, 16, 20 e 25 fjala “autorizim” zëvendësohet me fjalën “licencë”.

Neni 49

**Ndryshime në ligjin nr.9876, datë 14.2.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme për transport”**

Në ligjin nr. 9876, datë 14.2.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme për transport”, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Veprimtaritë e përcaktuara në këtë ligj përfshihen në kategorinë VIII.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.”

2. Në nenin 7 fjala “autorizim” zëvendësohet me fjalën “licencë” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “autorizim” si në këtë nen.

Neni 50

**Ndryshime në ligjin nr.9108, datë 17.7.2003  
“Për substancat dhe preparatet kimike”**

Në ligjin nr. 9108, datë 17.7.2003, “Për substancat dhe preparatet kimike”, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 2 pika 14, fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “autorizim” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “leje” si në këtë nen.

2. Në nenin 19 bëhen ndryshimet e mëposhtme :

a) Fjala “autorizim” zëvendësohet me fjalën “licencim” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “leje” si në këtë nen.

b) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1.Licencimi mbështetet në kriteret e kualifikimit profesional dhe të gjendjes shëndetësore, për një person, juridik ose fizik, me zotësi të plotë juridike, që ka vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë e që nuk ka kryer vepra penale.”

c) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Licenca, e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përfshihet në kategorinë VIII.1 të shtojcës së ligjit për licencat dhe trajtohet sipas procedurave të ligjit për licencat.

4. Në nenin 20 fjalët “zyra e licencimit” zëvendësohen me fjalët “ministra përkatëse, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji.”.

Neni 51

**Ndryshime në ligjin nr.8025, datë 9.11.1995  
“Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar**

Në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Veprimtaritë e përcaktuara në këtë ligj përfshihen në kategorinë VIII.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.”.

**SEKSIONI I NËNTË  
FUSHA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

Neni 52

**Ndryshime në ligjin nr.7952, datë 21.6.1995  
“Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në nenin 44 bëhen ndryshime dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pika 1 numërohet 1/1.

b) Para pikës 1/1 shtohet pika 1 me këtë përmbajtje :

“1. Hapja e institucioneve arsimore private, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihet në kategorinë IX.1 të ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.”.

2. Në të gjithë përmbajtjen e ligjit fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “licencë”.

Neni 53

**Ndryshime në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007  
“Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar**

Në ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pas pikës 2 të nenit 43 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Veprimtaria e institucionit të arsimit të lartë e përcaktuar në këtë ligj, përfshihet në kategorinë IX.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i kësaj veprimtarie bëhet sipas dispozitave në vijim të këtij ligji.”.

**SEKSIONI I DHJETË  
FUSHAT E KUJDESIT SHOQËROR DHE PUNËSIMIT**

Neni 54

**Ndryshime në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005  
“Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar**

Në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, pika 1 e nenit 18 ndryshohet si më poshtë:

“1. Veprimtaritë e përkujdesit shoqëror, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë X.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.”.

Neni 55  
**Ndryshime në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995**  
**“Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, pika 3 e nenit 7 ndryshohet si më poshtë:

“3.Veprimtaritë e ndërmjetësimit për punësim dhe këshillim profesional, nga subjektet private, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë X.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.”

Neni 56  
**Ndryshime në ligjin nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar**

Në ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Veprimtaritë e arsimit dhe/ose formimit profesional, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen, sipas rastit, në kategorinë IX.1 ose X.2, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.”

2. Në të gjitha nenet e ligjit fjala “regjistrim” zëvendësohet me “licencim”.

3. Në nenin 22 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën “b”, fjalët “miraton krijimin ose riorganizimin e institucioneve jopublike, që realizojnë arsimin profesional e teknik, si dhe” shfuqizohen.

b) Shkronja “c” shfuqizohet.

4. Në nenin 23, shkronja “b” shfuqizohet.

SEKSIONI I NJËMBËDHJETË  
FUSHAT E DREJTËSISË DHE LIGJIT

Neni 57  
**Ndryshime në ligjin nr.7829 , datë 1.6.1994**  
**“Për noterinë”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në të gjitha nenet e ligjit fjala “leje” zëvendësohet me fjalën “licencë”.

2. Pas nenit 1 shtohet neni 1/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 1/1

Ushtrimi i veprimtarisë noteriale, e përcaktuar në këtë ligj, përfshihet në kategorinë XI.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i kësaj veprimtarie bëhet sipas dispozitave në vijim të këtij ligji.”

Neni 58  
**Ndryshime në ligjin nr.10 031, datë 11.12.2008**  
**“Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”**

Në ligjin nr.10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, bëhen këto

ndryshime:

1. Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

### **Subjektet që ushtrojnë shërbimin përbarimor gjyqësor privat**

1. Veprimet përbarimore kryhen vetëm nga individë, të pajisur me certifikatën e aftësisë profesionale të përbaruesit gjyqësor privat, dhe nën përgjegjësinë vetjake të tyre. Certifikimi bëhet sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Përbaruesi gjyqësor privat ushtron veprimet përbarimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Shërbimi përbarimor mund të ofrohet nëpërmjet një subjekti tregtar, duke respektuar përcaktimet në pikën 1 të këtij neni. Veprimtaria e këtyre subjekteve përfshihet në kategorinë XI.2, të shtojcës së ligjit për licencat. Kjo veprimtari licencohet sipas ligjit për licencat. Dispozitat e këtij ligji për përbaruesin gjyqësor privat vlejnë edhe për subjektin tregtar të licencuar për aq sa kanë kuptim.”.

2. Në nenin 10, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) jep, pezullon ose heq certifikatën e përbaruesit gjyqësor, privat dhe pezullon ose heq licencën e subjektit tregtar, që ofron shërbimin privat përbarimor.”.

3. Në të gjithë krerët III e IV, fjala “licencë” zëvendësohet me fjalën “certifikatë” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjitha nenet e ligjit, për të njëjtin përdorim të fjalës “licencë” si në këto krerë.

4. Neni 16 shfuqizohet.

5. Në nenin 19, teksti që fillon nga fjalët “Në pjesën e dytë” deri në fund të këtij neni shfuqizohet.

6. Në nenin 21, shkronja “ç” shfuqizohet.

Neni 59

### **Ndryshime në ligjin nr.8901, datë 23.5.2002**

#### **“Për falimentimin”, të ndryshuar**

Në ligjin nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar, në pikën 1 të nenin 43, fjala “licencuar” zëvendësohet me fjalën “certifikuar” dhe ky zëvendësim bëhet në të gjithë ligjin për të njëjtin kuptim.

### **SEKSIONI I DYMBËDHJETË FUSHAT E FINANCAVE PUBLIKE**

Neni 60

### **Ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008**

#### **“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”**

Në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nenet 52, 55, 56, e 123 pika 2, fjala “autorizim” zëvendësohet me fjalën “licencë”.
2. Pas nenit 51 shtohet neni 51/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 51/1

#### **Veprimtari ekspertize dhe/ose profesionale**

Veprimtaritë e përcaktuara në nenet 52, 55 pika 2 dhe 56 të këtij ligji, përfshihen në kategorinë XII.2 të ligjit për licenca. Këto veprimtari licencohen sipas dispozitave në vijim të këtij ligji.”.

Neni 61

### **Ndryshime në ligjin nr.10 091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të**

### **ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”**

Në ligjin nr.10 091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, pas pikës 2 të nenit 3 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Veprimtaritë e përcaktuara në këtë ligj përfshihen në kategorinë XII.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas dispozitave në vijim të këtij ligji.”.

Neni 62

### **Ndryshime në ligjin nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”**

Në ligjin nr. 10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjitha nenet, fjala “kategori” zëvendësohet me fjalën “lloje”.
2. Pas nenit 9 të kreut II shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 9/1

#### **Licencimi**

Veprimtaritë e përcaktuara në këtë ligj përfshihen në kategorinë XII.3, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.”.

KREU III

### **FILLIMI I EFEKTEVE DHE HYRJA NË FUQI**

Neni 63

#### **Fillimi i efekteve**

Ky ligj i shtrin efektet sipas afateve të përcaktuara në pikat 2 e 3 të nenit 55 të ligjit për licencat.

Neni 64

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6188, datë 25.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**